INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 2/40
Dt. 31.07.2025
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

INFRAKOS Sh.A

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Nr. Prot. 0113 Br. Prot. 3776
Data 07-08-25
PRISHTINË/A NO:1

NDËRMARRJA PUBLIKE
INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - INFRAKOS SH.A
Adresa: "Sheshi Lirisë" nr. 36, Fushë Kosovë tel. +383 38 550 550 500 www.infrakos.com

Në përputhje me nenin 19 të ligjit Nr.04/L-111, për plotësim ndryshimin e ligji Nr. 03/L-087 për ndërmarrje publike, në përputhje me pikën 15 dhe 26, nëb pika 26.14, 26.15, 26.16 dhe 26.17 të Kodin e Etikes për Qeverisje Korporative, nenin 15, paragrafi 15.2.3 pikat (k) të Statutit të ndërmarrjes nr. 2/52 datë 09/07/2024, Bordi i Drejtorëve i NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS Sh.A me datë 31/07/2025, merr ketë:

VENDIM

I. Aprovohen Pasqyrat Financiare për vitin 2024 të NP. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS SH.A, të audituara nga Auditori i Pavarur "Kerston Albania"

II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv që PF sipas pikës I, të këtij vendimi t'i procedoi në NJPMNP-ME.

III. Shfuqizohet vendimi Nr. 2/29 i dt. 19/06/2025.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve.

INFRAKOS SH.A. · Fushë Kosovë · INFRAKOS D.D. · INFRAKOS J.S.C. · 2

znj, Edona NAHI

Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
NP. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
INFRAKOS Sh.A

Vendimi i dërgohet:
- *Bordit të Drejtorëve*
- *Kryeshefit Ekzekutiv*
- *NJPMNP - ME*
- *Arkivit të ndërmarrjes*

KRESTON ALBANIA

Growth
Innovation
Impact

knowing you.

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr.No.Br. 2/34
Dt. 08.07.2025
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

KRESTON ALBANIA

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Drejtimit dhe Aksionarit të shoqërisë "Infrastruktura E Hekurudhave Të Kosovës - Infrakos"sh.a.

Raport auditimi

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të shoqërisë "Infrastruktura E Hekurudhave të Kosovës- Infrakos" sh.a. (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, duke përjashtuar efektet e mundshme të çështjes së përshkruara në seksionin e raportit tonë "Baza e Opinionit të kualifikuar", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe flukset monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 të hartuara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinionin të kualifikuar

1. Siç është paraqitur në shënimin "Rezervë Rivlerësimi" të pasqyrave financiare Shoqëria ka raportuar në vlerën prej 15 milion Eur (2023: 15 milion Eur). Shoqëria nuk ka rivlerësuar jetëgjatësinë e pasurive afatgjata materiale, praktikë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Finanicar ("SNRF"). Për shkak të natyrës së transaksioneve të Shoqërisë dhe duke përdorur metodat alternative të auditimit ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim ishte i nevojshëm për t'u bërë në zërat e raportuara të pasurive afatgjata materiale, në pasqyrën e pozicionit financiar dhe vlerave përkatëse në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrës së ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2024.

2. Siç është paraqitur në shënimin "Grantet e shtyra" të pasqyrave financiare Shoqëria ka raportuar në vlerën prej 47 milion Eur më 31 dhjetor 2024 (2023: 40 milion Eur). Ne nuk ishim në gjendje të merrnim konfirmime dhe rakordime nga palët e treta në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e këtyre shumave. Si rezultat i kësaj çeshtjeje, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime në lidhje me vlerën e granteve të shtyra, si dhe me elementët të cilët ndikojnë në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë.

3. Siç është paraqitur në shënimin "Zotimet dhe kontigjencat" të pasqyrave financiare, Shoqëria është paditur në disa çështje ligjore si civile, penale apo marrdhënje pune, për të cilat nuk ka ngritur një fond provigjionesh për të gjitha çështjet, praktikë e cila nuk është në përputhje me Standardet

Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Në çështjet ligjore në proces Shoqëria ka dhe padi të lidhura me pronësinë e pasurive afatgjata materiale. Si rezultat i kësaj çeshtjeje, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime në lidhje me vlerën e llogarive të provigjioneve, si dhe me elementet të cilët ndikojnë në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të modifikuar.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen në lidhje me pasqyrat finaciare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brëndshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, perveçse sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një

bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Shoqëria "Kreston Albania" sh.p.k

Rezar Llukaçej
Auditues Ligjor

Shoqëria "Kreston Albania" L.L.C

Nuriona Bërdica
Auditues Ligjor

Prishtinë, më 1 korrik 2025

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 2/27
Dt. 06.05.2025
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës

INFRAKOS SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2024

Fushë Kosovë

Mars 2025

PËRMBAJTJA	FAQE
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	6
INFORMATA TE PERGJITHESHME	7
PERMBLEDHJE E POLITIKAVE DOMETHENSE TE KONTABILITETIT	8
SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT	18

INFRAKOS SHA
PASQYRAT FINANCIAR PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31DHJETOR 2024

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e pozitës financiare

Më 31.12.2024

PASURITË	Shënimi	2024	2023
Pasuritë afatshkurtra		€	€
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	934,584	582,762
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	2,432,573	1,757,266
Stoqet	6	725,140	817,323
Pasuritë e tjera afatshkurtra	7	103,050	51,631
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		4,195,347	3,208,982
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet		14,382,806	15,170,811
Investimi në vijim		102,438,420	85,030,210
Gjithsej pasuritë afatgjata	8	116,821,225	100,201,021
Gjithsej pasuritë		**121,016,573**	**103,410,003**
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	51,337	47,457
Grantet e shtyera	13	46,997,945	40,080,848
Tatimet dhe kontrib.pens.te pagushme	14	1,112,887	1,270,315
Detyrime te tjera afatshkurte	15	2,059,134	-
Provizone per raste gjyqsore	16	32,946	-
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		50,254,248	41,398,620
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	17	58,442,293	50,555,832
Gjithsej detyrimet afatgjata		58,442,293	50,555,832
Gjithsej detyrimet		108,696,541	91,954,452
EKUITETI			
Kapitali i aksionar	9	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	10	(3,825,006)	(3,795,464)
Rezervat Rivlersimit	11	15,226,015	15,226,016
Fitimi i vitit		894,022	-
Gjithsej ekuiteti		12,320,031	11,455,552
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		**121,016,573**	**103,410,003**

INFRAKOS SHA. Fushë Kosovë

z. Kadri Kastrati
Kryesues Ekzekutiv

znj.Syleme Ahmeti-Bllaça
Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e të ardhurave gjithëpërshirëse për vitin që përfundon

Më 31.12.2024

	Shënimi	2024	2023
		€	€
Të hyrat		2,568,992	2,014,569
Të hyrat tjera afariste		931,318	171,653
Të hyrat nga grantet		869,060	984,927
Të hyrat operative	18	4,369,371	3,171,149
Të ardhurat tjera			
Shpenzimet e pagave	19	(1,810,719)	(1,710,138)
Shpenzimet administrative & tjera	20	(405,146)	(386,404)
Shpenzimet e zhvlersimit	21	(871,500)	(1,060,796)
Shpenzimet e zhvlersimit te stokut	21.1	(92,346)	
Shpenzimet e provizionimit borxheve te kqija	22	(163,713)	(549,230)
Shpenzime e provizionimit per raste gjyqssore	23	(32,946)	
Shpenzimet operative		(3,376,370)	(3,706,568)
Shpenzimet financiare	24	(80,225)	(149,380)
Fitimi / (humbja) para tatimit		912,776	(684,799)
Shpenzimet e tatimit në fitim		18,754	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		**894,022**	**(684,799)**

Shënimet shoqëruese nga faqja 18 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon

Më 31.12.2024

	Shënim	2024	2023
		€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		894,022	(684,799)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		(29,542)	
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		871,500	1,060,796
Shpenzimet financiare		80,225	149,380
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	
		1,816,205	525,377
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të Tjera		(726,726)	949,060
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		92,183	47,598
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		3,879	(608,398)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		1,934,651	(669,993)
Rritja / (zvogëlimi) në grante		6,917,097	7,899,126
		10,037,288	8,142,770
Tatimi në fitim i paguar		-	(57,458)
Interesi i paguar		(80,225)	(41,407)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		9,957,063	8,043,905
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, dhe aseteve tjera		(83,493)	(224,845)
Investime ne projekte kapitale		(17,408,210)	(24,830,366)
Neto rrjedha nga aktivitetet investuese		(17,491,703)	(25,055,211)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Terheqjet			
Ndryshimi ne huazime		7,886,461	16,246,436
Neto rrjedha nga aktivitetet financiare		7,886,461	16,246,436
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		351,821	(764,870)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		582,763	1,347,633
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		934,584	582,763

Shënimet shoqëruese nga faqja 18 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon

Më 31.12.2024

	Rishikuar			
	Kapitali I pronarit	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2023	25,000	(3,110,665)	15,226,015	12,140,350
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(684,799)		- (684,799)
Terheqje Kapitalit/deponim				
Gjendja më 31 dhjetor 2023	25,000	(3,795,464)	15,226,015	11,455,551
Fitimi / (humbja) i/e vitit		894,022		894,022
Terheqje Kapitalit/deponim	-			-
Korrigjim I fitimit te mbajtur		-29,542		(29,542)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	25,000	(2,930,984)	15,226,015	12,320,031

Shënimet shoqëruese nga faqja 18 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. INFORMATA TE PERGJITHESHME

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutes së Republikës së Kosovës, Neni 33 paragrafi 1, të Ligjit mbi Hekurudhat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-076, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr.01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26 Shkurt 2010 mori Vendim mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës SH.A.
Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087, për "Kompanitë Publike"; Ligjit Nr.02/L-123, për "Kompanitë Tregtare" dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr.05/110 të datës 26.02.2010 për ndarjen e Hekurudhat e Kosovës SH.A. , themelon:
Shoqërinë Aksionare "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A." me NUI 811415620, e cila është përgjegjëse për asetet, pronën, dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin si pasojë e këtij transformimi.
Shkurtesa e emërtimit është "INFRAKOS" SH.A.
Selia e kompanisë gjendet në Komunën e Fushë Kosovës "Sheshi i Lirisë" pn. Kompania mund të zhvilloj aktivitetin e saj në territorin e Kosovës dhe jashtë saj.
Kompania, sipas Statutit të saj dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës mund të hapë Qendra zyra përfaqësuese, filiale, degë dhe kompani të tjera si në Republikën e Kosovës ashtu edhe jashtë vendit.
Shthurja financiare e Hekurudhave të Kosovës SH.A. është bërë nga grupi punues i përbërë prej tetë anëtarëve bazuar në vendimin e dates 18.05.2010 Nr.571. në bazë të cilit vendim është bërë ndarja e mjeteve financiare, ndarja e borxheve dhe ndarja e obligimeve financiare në dy kompani të reja "INFRAKOS" SH.A. dhe "TRAINKOS"

1.1 Aktivitetet biznesore të kompanisë

Fushëveprimi kryesorë i kompanisë është; Menaxhimi, mirëmbajtja, renovimi, përmirësimi dhe ndërtimi i infrastrukturës hekurudhore (linjave hekurudhore, stabilimenteve sinjalo-siguruese, stabilimenteve telekomunikuese, stabilimenteve të energjetikës, objekteve të stacineve dhe objekteve tjera për ofrimmin e shërbimeve) ofrimi i shërbimeve në terminalet e mallrave, menaxhimi, mirëmbajtja, renovimi, ndërtimi dhe dhënia në shfrytëzim e pronës dhe objekteve të Infrastruktures hekurudhore për përfitime komerciale, menaxhimin e trafikut hekurudhor nëpër të gjitha linjat hekurudhore të Kosovës dhe pjesët e linjave të cilat e lidhin Kosovën me shtetet fqinje, si dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve tjera të nevojshme për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore (operatorët me trena)

1.2 Qeverisja e Kompanisë

NP.INFRAKOS SHA qeveriset nga BoD i zgjedhur nga aksionari (Qeverisa e R.Kosoves), i cili menaxhon me NP permes struktures organizative të miratuar nga BoD.

1.3 Personeli i Kompanisë

Gjatë vitit ushtrimor Janar - Dhjetor 2023, Kompania kishte mesatarisht 233 të punësuar, gjersa gjatë vitit ushtrimor Janar - Dhjetor 2024 kishte mesatarisht 230 të punësuar.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA

2.1 Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2017

SNRF 16 'Qiratë'
SNRF 16 "Qira" SNRF 16 'Qiraja' zëvendëson SNK 17 'Qira' së bashku me tre Interpretime (KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira', SIC 15 'Qira-Nxitjet Operative' dhe SIC 27 'Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje '). SNRF 16 kërkon që qiradhënïet të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një pasuri me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë. Ekzistojnë dy lehtësime të rëndësishme të parashikuara nga SNRF 16 për aktivet me vlerë të ulët dhe qiratë afatshkurtra më pak se 12 muaj.
Zbatimi i SNRF 16 nuk ka asnjë efekt në pozicionin financiar dhe performancën financiare të Kompanisë, si dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 gjithashtu, pasi që Kompania nuk ka kontratë qiraje në ato data dhe periudha të konsideruara.

2.2 Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të miratuara

Kompania ka zbatuar të gjithë Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('IASB') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Çdo standard ose interpretim i kontabilitetit i ri ose i ndryshuar që nuk është ende i detyrueshëm nuk është miratuar më herët. Zbatimi i këtyre standardeve dhe interpretimeve nuk kishte ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- Ndryshimet në SNRF 3 Përkufizimi i një biznesi;
- Ndryshimet në SNRF 7, SNRF 9 dhe SNK 39 Reforma e Vlerësimit të Interesit;
- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 Përkufizimi i Materialit;
- Ndryshimet në SNRF 16;
- Korniza Konceptuale për Raportimin Financiar.

2.3 GJYKIMET KRITIKE NË APLIKIMIN E POLITIKAVE TË KONTABILITETIT TË KOMPANISË

Nuk ka gjykime kritike, përveç atyre që përfshijnë vlerësime që menaxhmenti ka bërë në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Kompanisë dhe që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në këto pasqyra financiare.

2.3.1 Burimet kryesore për vlerësimin e pasigurisë

Në vijim janë supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në fund të periudhës raportuese, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të mbajtjes së pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

2.3.2 Zhvlerësimi dhe jetëgjatësia funksionale e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Pasuritë e kompanisë përbëhen nga instalime të mëdha dhe komplekse. Ato janë të shtrenjta për t'u ndërtuar, priren të jenë të ekspozuar ndaj kushteve të vështira operative dhe kërkojnë zëvendësim ose riparim periodik. Pasuritë gjenerues përbëhen nga një numër i konsiderueshëm i komponentëve, shumë prej të cilëve do të kenë jetëgjatesi të ndryshme. Siç përshkruhet në shënimin 2.6 më lart, Kompania rishikon jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar të pasurisë, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave ose faktor tjetër mund të ndikojë në jetëgjatësinë e dobishme të pasurive dhe, në përputhje me rrethanat, mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën kontabël të atyre pasurive.

2.3.3 Lejimet nga humbjet e pritshme kreditore

Lejimet për vlerësimin e humbjeve të pritura kreditore kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Bazohet në humbjen e pritshme të jetëgjatësis, e grupuar në bazë të arkëtimeve të prapambetura dhe jo të detyrueshme dhe bën supozime për të ndarë një normë të përgjithshme të pritshme të humbjes kreditore për secilin grup. Këto supozime përfshijnë përvojën e shitjeve të fundit dhe nivelet e mbledhjes historike.

2.3.4 Provizionimi për dëmtimin e inventarit

Vlerësimi për provizionim për dëmet e inventarit kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Menaxhmenti bënë vlerësimin e dëmit të inventarit bazuar në lëvizjen e inventarit gjatë vitit. Bilanci i dëmtimeve llogaritet çdo fundvit dhe sigurohet inventari që nuk ka lëvizur për mbi 365 ditë.

2.3.5 Provizionet në lidhje me përfitimet e stafit

Provizionet njihen në pasqyrat financiare të kompanisë për pagesa në lidhje me pensionet plotësuesedhe qiratë paguhen bazuar në vendimet gjyqësore, për personat e dëmtuar në vendin e punës që kanë humbur aftësinë për të punuar dhe për anëtarët e familjes së tyre në rast se personi ka vdekur në vendin e punës. Menaxhmenti bën vlerësime vjetore në lidhje me bilancin që duhet të llogariten në lidhje me detyrimin e kompanisë për pagimin e pensioneve shtesë dhe qirave.

2.3.6 Vlerësimi i çështjeve gjyqësore

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësimin për shumat e shlyerjes së çështjeve gjyqesore të udhëhequra nga udheheqsi i sektorit ligjor i Kompanisë. Mbi bazën e këtij vlerësimi, Kompania në përputhje me rrethanat regjistron provizionet, nëse ka, ose shpalos përgjegjësinë e mundshme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

2.3.7 Vlerësimi për çështje mjedisore, dekomisionim dhe çështje të tjera të lidhura

Aktualisht nuk ka kërkesë ligjore detyruese për dispozitat mjedisore, dekomisionimin dhe dispozitat e tjera të lidhura me të në Kosovë. Kompania rregullisht kryen vlerësimet e saj të brendshme për provizione të tilla dhe i njeh ato në varësi të natyrës dhe rrethanave përreth këtyre dispozitave. Në varësi të natyrës dhe madhësisë së operacioneve të Kompanisë në të ardhmen dhe më tej nga çdo ndryshim i mundshëm në kornizën ligjore në Kosovë, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet e Kompanisë.

2.3.8 Tatimet

Detyrimi tatimor i Kompanisë për aktivitetet operative është shuma e gjithsej detyrimeve tatimore aktuale. Llogaritja e gjithsej tatimit të Kompanisë përfshin domosdoshmërisht një shkallë vlerësimi dhe gjykimi në lidhje me zëra të caktuar, trajtimi tatimor i të cilave nuk mund të përcaktohet përfundimisht derisa të arrihet një zgjidhje me autoritetin përkatës tatimor ose, sipas rastit të jetë, përmes një procesi zyrtar juridik. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të ketë një ndikim material në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe / ose variancave në rrjedhën e parave.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore kontabël të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

3.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë përgatitur si dhe për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023. Të dhënat aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, e cila është gjithashtu valuta funksionale e Kompanisë.

3.3 Bazat e përgaditjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën koventën e kostos historike. Bazat e matjes janë përshkruar më detajisht në politikat e kontabilitetit më poshtë.
Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare.

3.4 Supozimi i parimit të vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

3.5 Valuta funksionale dhe prezentimet

Valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë është euro (EUR) e cila është në pajtueshmëri me rregullativat e Unionit Monetar Europian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, valuta euro është adoptuar si valutë e vetme legale në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.
Pasqyrat financiare janë përgaditur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyra financiare janë të shprehura në euro, përveç nëse kërkohet të janë të shprehura ndryshe. Sipas nevojës, figurat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

3.6 Transaksionet në valutë të huaj

Në fund të çdo periudhe të raportimit, zërat monetarë të mbajtur në valutë të huaj konvertohen në valutën funksionale me normat që mbizotërojnë në atë datë. Zëra jomonetarë të mbajtur me vlerë të drejtë që janë të shprehur në valutë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zëra jo monetarë që janë matur në terma të kostos historike në valutë të huaj nuk rikonvertohen.

Diferencat e këmbimit për zërat monetarë njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin me përjashtim të:

- Diferencave të këmbimit nga huamarrjet në valutë të huaj që lidhen me pasuritë në ndërtim e sipër për përdorim produktiv në të ardhmen, të cilat janë të përfshira në koston e këtyre pasurive, kur ata konsiderohen si një rregullim i kostove të interesit për ato huamarrje në valutë të huaj.

- Diferencave të këmbimit për transaksionet e ndërmarra me qëllim të mbrojtjes nga rreziqet e ndryshme të valutave të huaja; dhe
- Diferencat e këmbimit për zërat monetarë të arkëtueshme nga ose të pagueshme ndaj një operacioni në valutë huaj për të cilin shlyerja nuk është planifikuar dhe as ka gjasa për të ndodhur (pra, duke formuar pjesë të investimit neto në operacionin në valutë të huaj), të cilat janë njohur fillimisht në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe të riklasifikuara nga kapitali në fitim ose humbje në shlyerjen e detyrimit të zërave monetare.

3.7 Instrumentet financiare

Njohja dhe ç'regjistrimi
Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar.
Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose kur transferohen pasuritë financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet. Një detyrim financiar çregjistrohet kur ajo shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

3.8 Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një material të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për shpenzimet e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).
Aktivet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kostoja e amortizuar
- vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPPH)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDPATGJ).

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si VDPATGJ.

Klasifikimi përcaktohet nga dy:
- modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivit financiar
- karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të aktivit financiar.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare që njihen në fitim ose humbje janë paraqitur brenda kostove financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjera financiare, me përjashtim të depozitimit të tregtueshmërisë të arkëtueshme që paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

3.9 Matja e më pasëshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuar si VDPPH):
- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të saj
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja është lënë jashtë ku efekti i zbritjes është jomaterial. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, tregtia dhe shumica e të arkëtueshmeve të tjera bien në këtë kategori të instrumenteve financiare

Instrumentet financiare (vazhdim)

3.10 Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPPH)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga " të mbajtura për tu arkëtuar" ose "mbajtja për të grumbulluar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga asetet financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në VDPPH.
Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

3.11 Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDPATGJ)

Kompania llogarit pasuritë financiare në VDPATGJ nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

• ato mbahen në një model biznesi, qëllimi i të cilit është "të mbajtura për tu arkëtuar" e parave të lidhura rrjedh dhe shesin dhe;
• kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse (OCI) do të riciklohet pas mosnjohjes së aktivit.

3.12 Pronat, impiantet dhe paisjet

Pronat, impiantet dhe paisjet maten me kosto duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejtë të ngarkueshme me blerjen e pasurisë. Kosto e pasurive të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë (nëse është përfshirë), ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e pasurisë në gjendjen funksionale për përdorimin e synuar. Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (përbërësit madhor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve
Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të pasurive afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të pasurive afatgjata materiale dhe njihen neto brënda "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.
Pronat në rrjedhën e ndërtimit për prodhim, ose për çështje administrative, ose për qëllime ende të papërcaktuara, barten në kosto, minus çdo humbje nga zhvlerësimi e njohur. Kosto përfshinë tarifat profesionale dhe, për pasuritë e kualifikuara, kostot e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikat kontabël të kompanisë. Zhvlerësimi i këtyre pasurive, në të njëjtën bazë si aktivet e tjera të pronësisë, fillon kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar.

Mobilet, orenditë, paisjet dhe automjetet paraqiten me koston e tyre pa zhvlerësim të akumuluar dhe pa humbjet e akumuluara nga dëmtimet.

3.13 Pronat, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

Zhvlerësimi ngarkohet në atë mënyrë që të zvogëlojë koston ose vlerësimiun e pasurive, përveç Tokës dhe pronave në ndërtim e sipër, gjatë jetës së tyre të vlerësuar të përdorimit, duke përdorur metodën lineare, si vijon:

Ndërtesat dhe rrjeti hekurudhor	20 vite
Impiantet dhe makineritë	10 vite
Mobilet, paisjet, veturat	5 vite

Në bazë të shtesave dhe hudhjeve gjatë vitit, zhvlerësimi ngarkohet prej muajit të blerjes deri te muaji përkatës i asgjësimit.

Jetët e vlerësuara të përdorimit, vlerat e mbetura dhe metodat e zhvlerësimit rishikohen në çdo fund vit, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël në të ardhmen.
Fitmi ose humbja që vjen nga hudhja apo asgjësimi të ndonjë pjese të pronave, impianteve ose paisjeve përcaktohet si një diferencë në mes të të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të një aseti dhe është e njohur në pasqyren e të ardhurave dhe humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si pasuri e ndarë, sipas rastit, sipas nevojës, vetëm atëherë kur është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen të lidhura me atë artikull do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të sigurt. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera paraqiten në pasqyren e ardhurave ose humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilen kanë ndodhur.

3.14 Pasuritë e paprekshme

Njohja dhe matja

Pasuritë e paprekëshme përbëhen nga licencat dhe programet kompjuterike. Këto pasuri të paprekëshme janë paraqitur fillimisht me kosto dhe më pas me koston e tyre duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë. Amortizimi është njohur në bazë lineare përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim duke u llogaritur në baza të ardhme.

3.15 Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese janë kapitalizuar vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të krijuar brënda, njihet në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

3.16 Zhvlersimi

Zhvlersimi llogaritet mbi koston e pasurisë, duke i zbritur vlerën e saj të mbetur.
Zhvlersimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për softver me një normë vjetore prej 20%.

3.17 Stoqet

Stoqet maten me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja e stoqeve është e bazuar në parimin e "çmimit mesatar", dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara me rastin e blerjes së inventarëve, kostot e prodhimit apo të konvertimit dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara në sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.
Materialet dhe pjesët rezervë janë shpenzuar ose kapitalizuar, kur instalohen.
Një provizion për stoqe me qarkullim të ulët dhe inventarë të vjetëruar njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhimit.

3.18 Instrumentet financiare

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë bilancet e parave të gatshme, llogaritë bankare dhe depozitat me afat, me afat maturimi më pak se tre muaj.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare regjistrohen fillimisht në shumën e arkëtueshme kundrejtë shitjes së produkteve. Në vazhdimësi, llogaritë e arkëtushme paraqiten me koston e tyre nominale duke i zbritur provizionet për borxhet e dyshimta.

Lejimi për borxhet e dyshimta njihet kur ka dëshmi objektive që një arkëtueshmëri e caktuar është e dëmtuar.

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.19 Instrumentet financiare (vazhim)

Instrumentet tjera financiare
Instrumente të tjera jo-derivative janë matur me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Kompanisë njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë të klasifikuara si kapital.

3.20 Zhvlerësimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjes së pritshme kreditore (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe VDPATGJ, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë e kontratës të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe zotimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.Njohja e humbjeve kreditore nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes kreditore. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritshme kreditore, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një ndarje midis:

• instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga fillimi njohjes ose që kanë rrezik të ulët kreditor ('Faza 1') dhe
• instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kreditor i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.
• Humbjet e pritshme kreditore në 12 muajtë 'njihen për kategorinë e parë, ndërsa' humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë 'njihen për kategorinë e dytë.
Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve kreditore gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar

3.21 Grantet qeveritare

Një grant qeveritar njihet vetëm atëherë kur ekziston një siguri e arsyeshme mbi kushtet prej të cilave përbëhet granti dhe që granti do të pranohet.Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës që nevojitet të përputhet e ardhura me kostot e lidhura, për të cilat ata janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin. Kur granti është i lidhur me të ardhurat, shlyerja duhet të zbatohet fillimisht kundër ndonjë detyrimi të lidhur të paamortizuar të shtyrë, dhe çdo tejkalim duhet të trajtohet si shpenzime. Kur granti ndërlidhet me një pasuri, shlyerja duhet të trajtohet si rritje në vlerën kontabël të pasurisë ose zvogëlimin në bilancin e të ardhurave të shtyera. Amortizimi kumulativ që do të ishte ngarkuar nëse granti nuk do të ishte pranuar, duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompensim për shpenzimet e bëra tashmë ose për mbështetje të menjëhershme financiare, pa shpenzimet e lidhura me të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai është i arkëtueshëm.Përfitimi i një granti në një normë të ulët të interesit të tregut, trajtohet si një grant qeveritar, i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuara dhe vlerat e drejta të kredisë të bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

3.22 Detyrimet financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Kompanisë nuk janë ndikuar nga miratimi i SNRF 9. Megjithatë, për plotësi, politika kontabël është dhënë më poshtë.
Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë huazimet, të pagueshmeve tregtare dhe të pagueshmeve tjera.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Kompania përcakton një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në VDPPH, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe të alokimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse.
Norma e interesit efektiv është norma që zbret pagesat e vlerësuara në kesh (duke përfshirë të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose të pranuara që formojnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit, kostove të transaksionit dhe primeve ose uljeve të tjera) gjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar , ose (kur është e përshtatshme) një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare.

3.23 Njohja e të hyrave

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

Për të përcaktuar nëse do të njohin të hyrat nga shërbimet, kompania ndjek një proces me 5 hapa:
1. Identifikimi i kontratës me një klient
2. Identifikimi i kushteve të performancës
3. Përcaktimi i çmimit të transaksionit
4. Alokimi i çmimit të transaksionit ndaj kushteve të performancës
5. Njohja e të hyrave kur / si kushtet e performancës janë të përmbushur

Të hyrat njihen ose në një moment ose në kohë, kur (ose) kompania përmbush kushtet e performancës duke transferuar mallrat ose shërbimet e premtuara për klientët e saj.

Kompania njeh detyrimet e kontratës për shumën e marrë në lidhje me kushtet e performancës së pakënaqur dhe raporton këto shuma si detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Kompania përmbush një kusht të performancës para se të marrë shumën, kompania njeh ose një pasuri të kontratës ose një të arkëtueshme në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, në varësi të faktit nëse kërkohet diçka tjetër përveç kohës së kalimit para se të bëhet pagesa.

3.24 Përfitimet e punëtorëve

Kompania, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionin e detyrueshëm sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të kompanisë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

3.25 Provizionet

Provizionet njihen kur Kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundshme që Kompania do të kërkohet për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund ti bëhet shumës së detyrimit.
Shuma e njohur si provizion është vlerësimi më i mirë i shumës që kërkohet për të shlyer detyrimin aktual në datën e bilancit, duke marrë parasysh rreziqet dhe pasiguritë që rrethojnë detyrimin. Kur një provizion matet duke përdorur rrjedhat e vlerësuara të flukseve monetare të nevojitura për të shlyer detyrimin aktual, vlera e tij kontabël është vlera aktuale e këtyre flukseve të mjeteve monetare (kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material).
Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion pritet që të rikthehen nga një palë e tretë, një e arkëtueshme njihet si një pasuri nëse është pothuajse e sigurt që rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet në mënyrë të besueshme.

3.26 Kontratat me kushte të pavolitëshme

Detyrimet aktuale që lindin nën kontratat me kushte të pavolitëshme njihen dhe maten si provizione. Një kontratë me kushte të pavolitëshme është konsideruar të ekzistojë kur Kompania ka një kontratë në të cilën kostot e pashmangshme të përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës tejkalojnë përfitimet ekonomike që priten të pranohen nga kontrata. Para se një provizion i veçantë për një kontratë me kushte të pavolitëshme është themeluar, një kompani njeh çdo humbje nga zhvlerësimi që ka ndodhur mbi pasuritë dedikuar për këtë kontratë.

3.27 Të hyrat dhe shpenzimet financiare.

Të ardhurat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi llogaritë rrjedhëse. Të ardhurat nga interesi njihen kur ato ndodhin në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje), duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huazimet, dhe humbjet nga rënia në vlerë të njohura në pasuri financiare, (nëse ka).

3.28 Shpënzimet e huamarrjës

Kostot e huamarrjes drejtpërdrejt të atribueshme për blerjen, ndërtimin ose prodhimin e pasurive të ndërlidhura, të cilat janë pasuri që domosdoshmërisht marrin një kohë të gjatë për të qënë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar ose të shitjes, janë shtuar në koston e këtyre pasurive, deri në kohën kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar apo për shitje. Të gjitha shpenzimet e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

3.29 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër i politikave dhe shpalosjet e kontabilitetit të kompanisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për të dyja, pasuritë dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe / ose shpalosjes duke u bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, informacion i mëtejshëm mbi supozimet e bëra gjatë përcaktimit të vlerave reale është shpalosur në shënimet specifike të pasurisë ose detyrimit përkatës.

3.30 Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, llogaritet si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, skontuar me normën e interesit të tregut për pasuri të ngjashme në datën e raportimit.

3.31 Detyrimet financiare jo-derivative
Vlera e drejtë, e cila është e përcaktuar për qëllime të shpalosjes, llogaritet në bazë të vlerës aktuale të rrjedhave monetare të principalit dhe interesit, të zbritur në normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

3.32 Zotimet dhe kontigjencat
Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e një rrjedhje të burimeve që përfshinë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare por zbulohet kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shuma e një humbjeje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë se një detyrim i shkaktuar si në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim të arsyeshëm të shumës së humbjes që rezulton mund të bëhet.

3.33 Transaksionet me palët e ndërlidhura
Palët e ndërlidhura përcaktohen si ato palë që kanë kontroll mbi njëri-tjetrin ose kanë ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëri-tjetrit. Për qëllimet e shpalosjes së pasqyrave financiare, aksionerët e shoqërisë dhe subjektet e tyre përkatëse konsiderohen palë të lidhura.

3.34 Ngjarjet pas datës së raportimit
Ngjarjet pas vitit të fundit që ofrojnë informata shtesë për pozicionin e një kompanie në pasqyrën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) janë pasqyruar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas fundvitit që nuk janë ngjarje të rregullimit shpalosen në shënimet kur janë materiale.

3.35 Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Kompania bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Përcaktohet që, vlerësimet e kontabilitetit shumë rrallë do të jenë të barabartë me rezultatet e ndërlidhura aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të rëndësishëm për të shkaktuar një rregullim material të shumat bartëse të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë adresuar më poshtë.

3.36 Jetët e dobishme e pronës, impianteve dhe pajisjeve
Siç përshkruhet në shënimin 3.6 më sipër, Kompania rishikon jetëgjatësinë e pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktor tjetër mund të ndikojë në jetët e dobishme të pasurive dhe në përputhje me rrethanat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme vlerën kontabël neto të këtyre pasurive.

3.37 Provizionet për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të shlyerjes së inventarëve
Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania e bën vlerësimin për rikthimin dhe realizimin e të arkëtueshmeve dhe inventarëve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti njeh një provizion të ërshtatshëm për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të inventarëve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

3.38 Tatimi
Ngarkesa e tatimit të Kompanisë në aktivitetet e zakonshme është shuma e totalit të ngarkesave tatimore aktuale dhe të shtyera. Llogaritja e pagesës totale tatimore të Kompanisë domosdoshmërisht përfshin një shkallë të vlerësimit dhe gjykimit në lidhje me zëra të caktuar, trajtimi tatimor i të cilëve nuk mund të përcaktohet përfundimisht deri sa është arritur një rezolutë me autoritetin tatimor përkatës ose, sipas rastit, nëpërmjet një procesi formal ligjor. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të kenë ndikim material në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe / ose variancave në rrjedhën e parasë.

4. PARAJA NË DORË DHE NË BANKË

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Paraja në dorë	-	-
Paraja në bankë	934,584	582,762
GJITHSEJ	934,584	582,762

5. LLOGARIT E ARKETUESHME

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Qasja në binar	521,930	627,160
Qiraja	2,629,754	2,087,222
Kerkesat të tjera	1,068,918	701,993
Proviz.per borxh.e keqija	-1,788,029	-1,659,108
GJITHSEJ KERK. NGA KLIENTET	2,432,573	1,757,267

Të arkëtueshme tregtare janë shuma për tu paguar nga klientët për ofrimin e sherbimeve të qasjese ne binar, dhe qirave të prones se kompanis në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Të arkëtueshmet tregtare zakonisht pranohen brenda 30 ditësh dhe për këtë arsye klasifikohen të gjitha si afatshkurtra. Llogaritë e arkëtueshme dhe paradhëniet e tjera janë të përbëra nga paradhëniet që u janë dhënë furnitorëve për punë dhe shërbime që duhen kryer, ndërsa arkëtimet e tjera janë shuma e dhen nga klientët për shërbimet e kryera.

Provizionimi i LL/A eshte kalkuluar sipas rregullores per provizionim e llogarive te arketushme te cilat jane specifikuar duke u bazuar ne kategorin e klienteve (borgjeve te vjetra). Provizionimi i LL/A eshte bere edhe në vitin 2023. Perveq provizonimit në vitin 2024, kemi edhe fshirjen e borgjeve të kqija në vlere prej 23,277.00 euro, te cilat kanë qenë të provizonuara ne vitin 2023.

Më 31 dhjetor 2024, perfshin gjendjen e stoqeve të Kompanisë duke përfshirë edhe stokun / inventarin e pranuar nga grantet, të gjitha stoqet perdoren për nevoja të Kompanis (material shpenzues, pjese ndrrimi/riparimi) dhe nuk kanë qellim shitjen e tyre.

6.STOQET

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Depoja epjesëve rez.nga BKK	509,788	467,143
Nafta	1,961	1,961
Depoja kryesore/HU	10,618	11,967
loco depo/HU	32,972	33,559
dep vajrave dhe lyerseve etj.	6,454	3,641
depoja e SS dhe TK/HU	245,477	296,201
depoja e binareve/HU	2,830	2,850
Depo ne stacion	7,388	-
Zhvlersimi i stokut	(92,346)	
GJITH. DEP.E PUNA NE PROGR.	725,140	817,323

7.PASURITË E TJERA AFATSHKURTA

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Parapagimet tatim 9%	93,691	43,003
LI/P avanset	9,359	8,628
GJITH. PAS.TJERA AFATSHKURTRA	103,050	51,631

8. TOKA, NDËRTESAT, PASURITË, PAJISJET

Kosto	Toka	Infra /	Impiante,Pajime	Investimi ne	Totali
Me 1 janar 2023	**10,552,320**	**8,367,916**	**13,212,120**	**60,199,844**	**92,332,200**
Blerjet gjate vitit		51,901	123,907	24,830,366	25,006,174
Shlyrjet gjate vitit		-			-
Me 31 dhjetor 2023	**10,552,320**	**8,419,817**	**13,336,027**	**85,030,210**	**117,338,374**
Blerjet gjate vitit	-	43,180	40,316	17,408,210	17,491,705
Shlyrjet gjate vitit	-	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2024	**10,552,320**	**8,462,997**	**13,376,342**	**102,438,420**	**134,830,079**
Zhvlersimi I akumuluar					
Me 1 janar 2023	-	**(4,197,871)**	**(11,878,686)**	-	**(16,076,557)**
Zhvlersimi per periudhen	-	(543,130)	(517,666)	-	(1,060,796)
Shlyrjet gjate vitit					-
Me 31 janar 2023	-	**(4,741,001)**	**(12,396,352)**	-	**(17,137,353)**
Zhvlersimi per periudhen	-	(535,877)	(335,623)	-	(871,500)
Korigjim me 31.12.2024	-	(639,869)	-	-	(639,869)
Me 31 dhjetor 2024	-	**(5,916,747)**	**(12,731,975)**	-	**(18,648,722)**
Vlera neto e mbetur					
Me 1 janar 2023	**10,552,320**	**4,170,045**	**1,333,434**	**60,199,844**	**76,255,643**
Me 31 dhjetor 2023	**10,552,320**	**3,678,816**	**939,675**	**85,030,210**	**100,201,021**
Me 31 dhjetor 2024	**10,552,320**	**2,546,249**	**644,367**	**102,438,420**	**116,181,355**

Shtesat në pasurit e vitit 2024
Të përfshira në shumën totale të shtesave e vitit ne investimet ne vijim është shuma prej 17,408,210 euro, që lidhen me zërat e impianteve dhe pajisjeve të marra përmes huas dhe grantit.
Korrigjime jane bere tek investimet ne vijim, rehabilitimin e linjese 10 faza I eshte perfshi i gjithe investimi qe prej fillimit të projektit deri me 31/12/2024.
Asetet qe perfshihen nga rehabilitimi i linjes 10 janë: faza I perfshin relzionin nga H.Elezit – F.Kosove dhe faza II F.Kosove – Mitrovicë.

Pronat, impiantet dhe pajisjet të lëna peng
Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, nuk ka prona, impiantet apo pajisje të lëna peng. Të gjitha asetet janë përdorur për aktivitetet operative të kompanisë , ndersa vlera prej 639,869 euro pjese e infrastrukturës është vequar dhe do te saktësohet në të ardhmen së bashku me investimet nga rehabilitimi i linjes 10.

9. KAPITALI AKSIONAR

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Kapitali aksionar i zakonshëm	25000	25,000
GJITHSEJ	**25,000**	**25,000**

Me 31 dhjetor 2023 dhe 2024 dhe sipas regjistrit te biznesit të leshuar nga Agjensia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë me NUI: 811415620, kapitali i pergjitheshem i pajtuar arrim në EUR 25,000.
Përmban 25,000 aksione të zakonshme me EUR 1 për aksion. Aksionari i vetëm i Kompanisë është Qeveria e Kosovës.

10. FITIMET E MBAJTURA

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Saldo hapese	-3,795,464	-3,110,665
Fitimi&Humbja e vitit	894,022	-684,799
Korrigjim I fitimit te mbajtur	-29,542	-
Gjithsej	**-2,930,984**	**-3,795,464**

- Korrigjim i fitimit të mbajtuar behet per shkak se vertetohet se LL/A e konfirmuar nga Komuna e Drenasit ishte mbivleruar për shumën 3,245.52 Euro (trajtimi jo i duhur i subvenconit 2022) dhe poashtu LL/P Komuna e Podujeves ishte mbivlersuar per 110.44 Euro.
- Poashtu shpenzimet e interest per kredin -Kredia LUIV,masa 4.6, ne vitin 2023 nuk është njohur vlera 26,407.00 per periudhen (Nentor 2022-Maj 2023 sipas norms se interest 3.34%).

11. REZERVAT E TRANSFERIT

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Prona, impiantet dhe paisjet	15,226,015	15,226,015
GJITHSEJ	**15,226,015**	**15,226,015**

Rezervat, të cilat me 31 dhjetor 2024 kapin shumen prej EUR 15,226,015 (2022 njejte), fillimishte janë llogaritur në librat e kompanisë si diferencë midis kapitalit të regjistruar të aksioneve dhe vleresë së aktiveve neto të kompanisë, siq percaktohet nga vlersimi i pavaruar në daten e perfshirjesë së saj si SHA (2005). Këto rezerva hiqen nga shitja e aseteve të lidhura. Më tej keto asete nuk janë të disponueshme për shprendarje tek aksionari.
Rezervat përfshijnë gjithëashtu efektin e tatimit të shtyre (leshimin e detyrimit tatimor të shtyrë) të krijuar fillimisht në bazë të rivlersimit të pronës, impianteve dhe paisjeve pas kalimit ne SNRF.

12. LLOGARIT E PAGUESHME

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Furnitoret	51,337	47,456
GJITHSEJ FURNITORET	**51,337**	**47,456**

Të pagueshmet tregtare janë detyrime pa interes me furnitorët vendor dhe të huaj dhe normalishtshlyhen në një periudhë që shkon nga 30 ditë deri në 180 ditë.

13. GRANTET E SHTYERA

Grantet kanë të bëjnë me fondet ose pasuritë e fituara nga qeveria e Kosovës dhe / ose donatorët e tjerë me qëllim të veprimtarive operative të Kompanisë. Grantet e shtyra përbëhen nga parapagimet për projektet kapitale, të cilat janë në proces të ndërtimit dhe projekteve të ardhshme kapitale.

GRANTET BK

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
S.Fillestare	**3,940,751**	**4,708,590**
Te hyrat e shtyra	-869,060	-944,927
Grantet e pranuera të vitit BK	174,057	177,088
GJITHSEJ	**3,245,747**	**3,940,751**

Gjatë vitit 2024 Kompania ka pranuar grante nga Qeveria e R.Kosoves per realizimin e disa projekteve te vlersuara si të domosdoshme për funksionimin normal të veprimtaris se Kompanis.

TË TJERA	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Garanconi bankar /Grant BK-Softveri	4,118	41,182
Avanst LL/A	17,842	11,136
GJITHSEJ	21,960	52,318

GRANTET E REHABILITIMIT TË LINJES 10

	2008-2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Totali
WBIF	6,805,000	4,855,087	813,981	7,556,831	6,512,860	8,469,082	7,616,218	42,629,059
EBRD GRAN	610,837			4,824	313,713	145,565	26,240	1,101,179
GJITHSEJ								43,730,237

Grante te pranuera nga BK per vitin 2024 janë në vlerë prej 174,057 Euro.
Po ashtu kemi pranuar edhe grante nga WBIF ne vlerë prej 7,616,218 Euro - Rehabilitimi I Linjes 10, nga EBRD ne vlere prej 26,240.00Euro të cilat janë njoftë si të hyra të shtyera në PA për vitin 2024.

14. TATIMET E PAGUESHME

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Detyrimet ndaj ndeshkimeve ATK	313,379	313,379
Detyrimrt ndaj TVSH-së	278,475	464,401
Detyrimet ndaj Kontributeve dhe Tatimeve	-	-
Detyrimet ndaj tatimit burim	180	-
Detyrimet ndaj interesit ATK	520,853	492,535
GJTH. DETYRIMI NDAJ TAKSAVE	1,112,887	1,270,315.

Shpenzimet e interest&ndeshkimeve per vitin 2024 në ATK janë në vlere prej 28,318 Euro, ndersa ne vtin 2023 ishin 107,972Euro.

15. DETYRIMET TJERA AFATSHKURTRA: me Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës" Infrakos " SH.A. është mundësuar financimi i "Sigurimi I Vendkalimeve në Hekurudha" e cili sipas kontratës se nënshkruar me kon traktorin ka vlerën totale prej 995,979.00 e cila do të përfundoj në vitin 2025. Për vitin 2024 kemi investimin ne vijim me vlere prej 498,550.00 euro. Ky investim (pjesa e parë) është bërë në muajin dhjetor 2024, dhe pagesa nga MMPHI do të bëhet në fillim të vitit 2025 sipas marrëveshjes menr.3728/23 të datës 07.07.2023.
Mirëpo përderisa nuk kemi konfirmim nga MMPHI se e ka paguar qe sipas marrëveshjes është obligim i saj ne do ta paraqesim si detyrimi tjera afatshkurta.

Poashtu fatura per rehabilitimin e linjes 10, e cila financohet nga EBRD (me vlere 1,560 584) është mbetur të paguhet ne fillim te vitit 2025 (afati I pageses 30 ditë).

16. PROVIZIONET PËR RASTE GJYQËSORE: rasti i cili pritet te shkaktoj shpenzime dhe që është pjesë e detyrimeve kontigjent, i provizonuar është TechVizon SHPK me vlere totale 41,182.00 euro.

PROVIZIONIMET PËR RASTE GJYQËSORE

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Provizionimit per raste gjyqësore	32,946	-
GJITHSEJ	32,946	-

ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

INFRAKOS SHA ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qellim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes se interesave të ndërmarrjes, hartimin dhe implementimin e rregulloreve dhe akteve tjera ligjore të aplikueshme në Kompani.
Kompania ka vlerësuar se detyrimet kontingjente dhe provizionet nuk i kanë plotësuar kushtet të regjistrohen si provizione në pasqyrat financiare. Kompania ka bërë ndarjen e detyrimeve dhe provizioneve në kategori:

- Infrakos-i si e paditur jemi per vleren prej 4,558,968.00Euro, gjithesejt 94 lendë
- Infakos si padites janë ne vlere prej 1,839,516.87Euro, gjithesejt 294 lendë.

17. HUAZIMET

Marrëveshja e financimit e vitit datës 2016 e nënshkruar në mes të EBRD dhe EIB dhe Ministrisë së Infrastruktures dhe zotimeve nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës dhe Kompanisë.
Projekti parashikon rehabilitimin e Linjes 10 nderkombetare, nga Hani i Elezit kufiri me Maqedonin ne drejtim të verit te Kosoves Leshak kufirit me Serbin. Shuma totale e kredisë dhe marrëveshjes së financimit phasa i është €78,000,000.00, phasa II €47,927,505.32 dhe kontribut financiar. Kontributi financiar nuk do të rikthehet.

HUAZIMET

	Gjendja me 31.12.2024	Gjendja me 31.12.2023
Saldo hapse		
EBRD	17,473,878	15,637,993
EIB	30,353,667	27,360,415
Obligimet ndaj aksionarit per kthim te kredis EBRD	6,561,106	4,273,818
Obligim ndaj aksionarit Interes/angazhim 2024 Linja 10 kredi	2,362,688	1,670,204
Kredia LUIV,masa 4.6	395,671	1,187,014
Ob.ndaj aksionarit(pag.kesti dhe interesi - Kredia LUIV)	1,295,283	426,388
GJITHSEJ HUAZIMET AFATGJATA	58,442,293	50,555,832

Shfrytezimi i fondeve nga EBRD deri me 31/12/2024 është 24,034,894.00 Euro, Qeveria e R.Kosoves ka kthyer kredin në vlere prej 6,561,106.00Euro deri me 31/12/2024 – kredi afatëgjate
Ndersa nga EIB kemi pranuar fonde ne vlere prej 30,353,667.Euro deri me 31/12/2024, mirepo mjete te zotuara te lira ne Thesarin e Kosoves janë me vlere 6,946,333 euro pra totali është vlera 37,300,000 euro.

NP.INFRAKOS SHA ka pranuar nje kredi ne vitin 2022 sipas mases 4.6 LUIV - kredi afatëgjate.

18. TE HYRAT OPERATIVE

	Për periudhen 2024	Për periudhen 2023
Qasja ne binar (Mallrat & Udhetaret)	174,345	209,968
Qirja	1,276,135	958,928
Subv. mbul.e tarif.D.R -BK	1,118,512	845,674
Të hyrat nga grantet	842,820	944,927
Të hyrat nga granti BERZH	26,240	40,000
Të hyrat nga provizonim	11,515	
Miremb.binarit,sherb.perb & shitje tjera	919,804	171,653
GJITHSEJ TE HYRAT	**4,369,371**	**3,171,149**

Të hyrat nga Deklarata e rrjetit
Keto të hyra realizohen ne baze te deklarates vjetore te miratuar nga MPHAI, bazuar ne kete document behet edhe llogaritja e levizjes për tren/km.

Të hyrat nga qiraja
Këto të hyra gjenerohen përmes ofrimit te objekteve dhe hapsirave tjera me qira, kjo behet ne baze te rregullorese mbi dhenjen me qira të aprovuar nga BoD.

Të ardhurat nga Sub. i Qeverisë.
Gjatë vitit 2024, bazuar në marrveshjen e nenshkruar ne mes INFAKOS SHA dhe MEA, Kompania ka marrë subvension në vlere prej EUR 1,118,512 për mbulimin e differences se tarifave vjetore te miratuar me deklaraten per qasje në binar. Kjo shume nuk i mbulon diferencat nga deklarata e rrjetit, si rezultat I kesaj të hyrat janë me të vogla, e që gjithe kjo ndikon ne afarizmin e kompanis.

SHPENZIMET

Kompania gjatë kesaj periudhe kohore ka realizuar keto shpenzime të cilat janë paraqitur në tabelat e me poshtme.

19. SHPENZIMET PËR PAGA	Për periudhen 2024	Për periudhen 2023
Pagat e stafit	1,810,719	1,710,138
GJITH. SHPENZIMET PER PAGA	**1,810,719**	**1,710,138**

20. SHPENZIMET AD & MIREMBAJTJE TJER	Për periudhen 2024	Për periudhen 2023
Mirëmbajtjet e paisjeve	1,149	825
Mirëmbajtjet e rrjeteve	10,504	15,681
Shpenzimet e energjisë elektrike	65,681	95,282
Shpenzimet e karburanteve	25,421	25,851
Shpenzinet e vajrave	625	2,099
Materialet hargjuese operative	48,212	32,155
Riparimet	7,750	10,878
Sherbimet tjera operative	3,346	2,176
Udhëtime zyrtare	10,998	6,103
Shpenz e marketingut dhe publikimeve	29,200	42,755
Materiali i zyrës dhe hargjimeve	8,649	13,297
Shpenzimet e telefonit	8,846	9,250
Shpenz gjyqesore	71,661	30,317
Shpenzimet e reprezentacionit	7,100	7,558
Shpenz e sigurimit	44,627	41,331
Shpenz e stafit jashtëm	34	987
Shpenzimet tjera operative	29,876	49,860
Shpenzimet nga demtimi i stoqeve	31,470	-
GJITH. SHPENZIMET OPERATIVE	**405,146**	**386,404**

21. ZHVLERSIMI	Për periudhen 2024	Per periudhen 2023
Zhvlersimi i ndertesave	77,300	87,608
Zhvlersimi i Rrjetit	458,578	455,522
Zhvlersimi i mak	293,093	484,158
Zhvlersimi i paisjeve	18,742	11,467
Zhvlersimi i invetarit	23,788	22,041
GJITHËSEJT ZHVLEFTËSIMI	**871,500**	**1,060,796**

21.1 SHPENZIMET E ZHVLERSIMIT TË STOKUT	Për periudhen 2024	Për periudhen 2023
Shpenzimet e zhvlersimit te stokut	92,346	-
GJITHSEJ	**92,346**	**-**

22. SHPENZIMET E PROVIZIONIMIT	Për periudhen 2024	Për periudhen 2023
Shpenzimet e provizionimit	163,713	549,230
GJITHSEJ	**163,713**	**549,230**

Shpenzimet e provizionimit eshte kalkuluar sipas rregullores per provizionim e llogarive te arketushme te cilat jane specifikuar duke u bazuar ne kategorin e klienteve (borgjeve te vjetra). Provizionimi i LL/A është bere edhe në vitin 2023.

23. SHPENZIMET E PROVIZIONIMIT PËR RASTE GJYQËSORE

	Për periudhen 2024	Për periudhen 2023
Shpenzimet e provizionimit per raste gjyqësore	32,946	-
GJITHSEJ	32,946	-

Rasti i cili pritet te shkaktoj shpenzime dhe që është pjesë e detyrimeve kontigjent, i provizionuar është Tech-Vizon SHPK me vlere totale 41,182.00 euro.

24. SHPENZIMET FINANCIARE	Për periudhen 2024	Për periudhen 2023
Fee	763	750
LUIV Masa 4.6	51,145	30,717
Shp.Interesit ATK	28,317	107,973
Donacion	-	9,940
GJITH. FINANCIARE	80,225	149,380

25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Objektivat e Kompanisë kur menaxhon me kapital janë që të mbrojë aftësinë e Kompanisë për të vazhduar me vijimësinë në mënyrë që të ofrojnë kthime për aksionarët përmes optimizimit të gjendjes së borxhit dhe ekuitetit. Struktura e kapitalit të kompanisë përbëhet nga huazimet dhe kapitali i atribuar ndaj mbajtësit të kapitalit, që përfshin kapitalin, rezervat dhe humbjet e mbajtura.

Kompania është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:
- Rreziku i kapitalit
- Rreziku i tregut
- Rreziku i mallrave
- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Kompanisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat e Kompanisë dhe proceset për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Kompanisë. Shënime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.
Menaxhmenti ka përgjegjësi të përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e strukturës së administrimit të rrezikut të Kompanisë.
Menaxhimi i riskut kryhet nga Bordi Drejtues i bazuar në disa të politika të para-aprovuara dhe të shkruara dhe procedurave që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe fusha të veçanta, të tilla si rrezikun e normës së interesit, riskun e kredisë, përdorimin e letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimin e tepërt të likuiditet.

25.1 Rreziku i menaxhimit të kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që do të jetë në gjendje për të vazhduar në vijimësi, duke maksimizuar kthimin e aksionarëve nëpërmjet optimizimit të bilancit të borxhit dhe të kapitalit.
Struktura e kapitalit të Kompanisë përbëhet nga borxhi neto (huazimet kompensuar nga bilancet e parave të gatshme dhe bankare) dhe kapitali i shoqerisë (i përbërë nga aksionet e emëtuara, rezervat dhe fitimet e mbajtura).
Menaxhmenti rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, menaxhmenti konsideron koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me secilën klasë të kapitalit.
Raporti i borxhit dhe kapitalit në fund të periudhës raportuese është si vijon:

Raporti borxh/kapital

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2024	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2023
Borxhi (i)	58,442,293	50,555,832
Paraja e gatshme dhe paraja në bankë	-934,584	-582,762
Neto borxhi	57,507,709	49,973,070
Kapitali (ii)	12,320,031	11,455,552
Neto raporti borxh/kapital	466.78%	436.23%

(i) Borxhi është definuar si hua afatgjatë siç përshkruhet në shënimin 17.
(ii) Kapitali përfshinë të gjitha rezervat e kapitalit të Kompanisë që menaxhohen si kapital.

25.2 Rreziku tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, kurset e këmbimit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojnë në të hyrat e Kompanisë ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërsa duke optimizuar kthimin.

i) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga rreziku që vlera e instrumentit financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikun që maturitetet e pasurive që mbartin interes ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar këto pasuri (ri rreziku i çmimit). Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar, pra tregon se në çfarë mase ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.Për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 kompania nuk është ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

Rreziku i normës së interesit

	Me 31 dhjetor 2024	Me31 dhjetor 2023
Pasuritë		
Që nuk sjellin interes		
Të arkëtueshmet tregtare, paradhëniet ndaj furnitorëve dhe të arkëtueshmeve të tjera	2,432,573	1,757,266
Paratë e gatshme	934,584	582,762
Me normë fikse të interesit		
Paratë në bankë dhe depozitat me afat	-	
	3,367,157	**2,340,028**
Detyrimet		
Që nuk sjellin interes		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	51,337	47,457
Me normë fikse të interesit		
Huazimet	58,442,293	50,555,832
	58,493,630	**50,603,289**

Rreziku i tregut nuk është i përqendruar në rrezikun e monedhës së huaj, pasi shumica e transaksioneve të Kompanisë janë në monedhën vendase

25.3 Rreziku i mallit

Rreziku i sherbimit i referohet paqartësive të vlerave të ardhshme të tregut dhe të madhësisë së të ardhurave në të ardhmen, të shkaktuar nga luhatjet në çmimet e sherbimeve. Kompania ofron sherbime te qasjese ne rrjetin hekurudhore mirepo rehabilitimi I Linjes 10 ka ndikim direct ne renjen e transpotit hekurudhore, por

bazuar ne marrveshjen per mbulimin e humbjeve ne diferencev e qmimit sipas tarifave qe jane te percaktuera ne deklaraten e rrjetit.

25.4 Rreziku kreditor

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare të Kompanisë nëse konsumatori ose pala e kundërt ndaj një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe del kryesisht nga të arkëtueshmet e Kompanisë nga konsumatorët.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor:

Vlera kontabël e pasurive financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit të kredisë. Ekspozimi maksimal i kredisë ndaj riskut të kredisë, për periudhën 12 mujore që përfundoi më 31 dhjetor 2024, paraqitet si më poshtë:

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2024	Viti i përfunduar më 31 dhjeor2023
Paraja në bankë	934,584	582,762
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	2,432,573	1,757,266
Gjithsej	**3,367,157**	**2,340,028**

Në përcaktimin e rikuperueshmërisë së një llogarie të arkëtueshme, Kompania konsideron çdo ndryshim në cilësinë e kredisë së tregtimit të arkëtueshëm që nga data kur kredia fillimisht ishte dhënë deri në fund të periudhës raportuese.

Garancia e mbajtur si siguri

Kompania nuk mban asnjë kolateral ose zgjerime të tjera të kredisë për të mbuluar rreziqet e saj të kreditit që lidhen me aktivet e saj financiare.

25.5 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Kompania do të has në vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që do të përmbushen duke dhënë mjete monetare ose pasuri financiare tjetër.

Qasja e Kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, se ajo vazhdimisht do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur ato duhet të paguen, ndër kushte normale dhe të vështirësuara, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Kompanisë. Rreziku i likuiditetit lind në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të Kompanisë dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ajo përfshin si rrezikun e të qenit në gjendje për të financuar pasuritë me maturime dhe norma të përshtatshme dhe rrezikun e të qenit të paaftë për të likuiduar një aktiv me një çmim të arsyeshëm dhe në një kornizë të përshtatshme kohore për të përmbushur detyrimet financiare.

Detyrimet financiare duke përfshirë edhe pagesat e interesit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 NP Infrakos subvencionohet nga Ministria e Ekonomik për të financuar (mbuluar) projektet për investime kapitale, mirëpo edhe përkundër kësaj infrastruktura e Hekurudhave në Kosovë është në gjendje të vështirë dhe paraqet një problem mjaft të madh për vendin tonë.

Për shkak të vështërsive të afarizmit, NP Infrakos ka operuar me humbje financiare ku shpenzimet e përgjithshme janë më të larta se të hyrat operative. Aksionari dhe Bordi i drejtorëve duhet të jenë më aktiv për të shqyrtuar të gjitha aktivitetet e kryera nga menaxhmenti krahas rezultateve të arritura.

Detyrimet financiare

25.6 Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlerat e drejtë e pasurive dhe detyrimeve afatshkurtra është e përafërt më vlerat e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër. Vlera e drejtë e huave, gjithashtu përafron vlerën e drejtë sepse edhe pse ato janë

hua që mbartin norma fikse të interesit huadhënësi ka hequr dorë në kohë për të gjitha interesat nga kompania.
Vlera e drejtë e pasurive dhe detyrimeve financiare është e përfshirë në masën në të cilën instrumenti do të mund të shkëmbehet në një transaksion aktual midis palëve të vullnetëshme, përveç në një shitje të detyruar ose të likuidimit.

31 dhjetor 2024	Me pak se 1 muaj	1 deri 3 muaj	mbi 12 muaj	mbi 5 vite	Totali
Pasurite					
Paraja dhe ekuivalentet e saj	934,584	-	-	-	934,584
Te arketueshmet tregtare dhe te tjera		2,432,573	-	-	2,432,573
Totali i pasurive	**934,584**	**2,432,573**	**-**	**-**	**3,367,157**
Detyrimet					
Llogaritë e pagueshme		51,337	-	-	51,337
Kreditë dhe huazimet	-	-	58,442,293	-	58,442,293
Totali i detyrimeve	**-**	**51,337**	**58,442,293**	**-**	**58,493,630**
Pozita e likuiditetit	**934,584**	**2,381,236**	**(58,442,293)**	**-**	**(55,126,473)**
Hendeku i likuiditetit	**934,584**	**3,315,820**	**(55,126,473)**	**(55,126,473)**	

31 dhjetor 2023	Me pak se 1 muaj	1 deri 3 muaj	mbi 12 muaj	mbi 5 vite	Totali
Pasurite					
Paraja dhe ekuivalentet e saj	582,762	-	-	-	582,762
Te arketueshmet tregtare dhe te tjera		1,757,266	-	-	1,757,266
Totali i pasurive	**582,762**	**1,757,266**	**-**	**-**	**2,340,028**
Detyrimet					
Llogaritë e pagueshme		47,457	-	-	47,457
Kreditë dhe huazimet		-	50,555,832	-	50,555,832
Totali i detyrimeve	**-**	**47,457**	**50,555,832**	**-**	**50,603,289**
Pozita e likuiditetit	**582,762**	**1,709,809**	**(50,555,832)**	**-**	**(48,263,261)**
Hendeku i likuiditetit	**582,762**	**2,292,571**	**(48,263,261)**	**(48,263,261)**	

25.7 Instrumentet financiare të njohura me vlerën e drejtë (vazhdim).

Instrumentet financiare të njohura me vlerën e drejtë
Aktivet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë janë paraqitur në tabelën e ardhshme. Kjo hierarki grupon aktivet dhe detyrimet financiare në tri nivele që bazohen në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare:
Niveli 1: Çmimet e kuotuara (jo të rregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike;
Niveli 2: të dhënat tjera hyrëse, përveç çmimeve të kuotuara, të përfshira në Nivelin 1 që janë në dispozicion për vrojtimin e aktivit ose të detyrimit, direkt (si psh. si çmime) ose indirekt (p.sh. përbërë nga çmimet) dhe
Niveli 3: të dhënat hyrëse për aktivin ose pasivin që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme për vëzhgimin e tregut.
Kompania nuk ka asete të klasifikuar në këto kategori në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

25.8 Instrumentet financiare që nuk janë prezentuar me vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta për ato aktive dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë.

Më 31 dhjetor 2024	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
Pasuritë financiare		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	2,432,573	2,432,573
Paraja në dorë dhe në bankë	934,584	934,584
Gjithsej	**3,367,157**	**3,367,157**
Detyrimet financiare		
Huazimet	58,442,293	58,442,293
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	51,337	51,337
Gjithsej	**58,493,630**	**58,493,630**

Më 31 dhjetor 2023	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
Pasuritë financiare		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	1,757,266	1,757,266
Paraja në dorë dhe në bankë	582,762	582,762
Gjithsej	**2,340,028**	**2,340,028**
Detyrimet financiare	-	
Huazimet	50,555,832	50,555,832
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	47,456	47,456
Gjithsej	**50,603,288**	**50,603,288**

26. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët e lidhura përbëhen nga kompani, ndërmarrje të lidhura, kompanitë tjera të lidhura, drejtuesit e kompanisë dhe pjesëtarë të menaxhimentit kyç. Kompania në rrjedhën normale të biznesit kryen transaksione me palë të lidhura të ndryshme.

Të gjitha transaksionet me palët e lidhura janë kryer sipas termave dhe kushteve tregtare.

31 Dhjetor 2024	Grantet	Të hyrat e shtyera	Shpenzimet
Qeveria e Kosovës-Grant	3,245,747	842,820	-
Rehabilitimi I linjes 10 Granet	43,730,238	26,240	
Kompensim për menxhementin	-		38,094
Anëtarët e Bordit			24,776
Të tjera	21,960		
Gjithsej	**46,997,945**	**869,060**	**62,870**

31 Dhjetor 2023	Grantet	Të hyrat e shtyera	Shpenzimet
Qeveria e Kosovës-Grant	3,940,751	984,927	-
Rehabilitimi I linjes 10 Granet	36,087,779		
Kompensim për menxhementin	-		20,948
Anëtarët e Bordit			24,916
Të tjera	52,318		
Gjithsej	**40,080,848**	**984,927**	**45,864**

26.1 Borxhi afatgjatë

Një marrëveshje kredie e datës 08 dhjetor 2015 u nënshkrua midis Republikese se Kosoves perfaqsuar nga Ministria e Financave dhe EIB, dhe me dt.04 shtator 2015 u nenshkrua marrveshja nga Republikese se Kosoves perfaqsuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky projekt do të zbatohet bazuar ne keto kontrata. Projekti parashikon rehabilitimin e linjes 10 Hekurudhore nga H.Elezit - Leshak. Projekti është pjesë e planit zhvillimore të Hekurudhave dhe do të përfshijë ndërtimin, rehabilitimin dhe vënien në funksion të stacioneve, paisjeve sinjalo siguruese dhe linjave hekurudhore moderne. Kostoja totale e vlerësuar e projektit është rreth 208 milion euro. Burimet e parashikuara të financimit të projektit janë si më poshtë: 42 milion euro fondet e EIB (Marreveshja e Pare) dhe 38 milon fondet e poashtu nga EIB (Marreveshja e Dyte) ,si dhe 40 milion euro fonde BERZH dhe 126 milion euro Grant nga korniza e investimeve te ballkanit perendimore.

Projekti ka të beje me rehabilitimin e linjes hekurudhore 149 km te gjate, udhe e vetme me mates standart (1.435 mm) jo te elektrizuar ne Kosoven qendrore qe shtrihet te linjen e 10 te Hekurudhes Extended TEN-T dhe SEETO. Rehabilitimi do të lejoje operim deri 100 km/h në shumicen e seksioneve te linjes se bashku me 22.5-ton ngarkese boshtore ne perputhje me standartet e BE-se.

27. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Menaxhmenti i Kompanisë aktualisht po vlerëson ndikimin e mundshëm të situatës dhe konflikteve qe po zhvillohen ne bote mbi operacionet e tanishme të biznesit të Kompanisë. Menaxhmenti konsideron që kjo ngjarje është jo rregulluese në lidhje me pasqyrat financiare të Kompanisë, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024. Përveç kësaj, menaxhmenti konsideron që deri dhe nga data e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, aktivitetet e kompanise dhe pozicioni financiar mbeten materialisht të pa ndikuara nga kjo gjendje. Sidoqoftë, për shkak të pasigurisë së madhe të zhvillimit të ardhshëm të situatës aktuale ne bote, brenda vendit dhe ndërkombëtarisht, nuk mund të bëhen vlerësime të sakta të ndikimit të mundshëm në të ardhmen mbi pozicionin financiar të Kompanisë dhe operacionet e biznesit. Menaxhimi i Kompanisë i konsideron me kujdes të gjitha masat e ardhshme aktuale dhe potenciale të Qeverisë dhe është e angazhuar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të amortizuar krizën e ardhshme të shkaktuar nga konfliketet, në mënyrë që të sigurojë operacionet e vazhdueshme të biznesit duke planifikuar me kujdes likuiditetin e saj dhe duke i përshtatur situata e pësuar aktualisht në ekonominë lokale dhe globale.

Pas dates 31 dhjetor 2024 dhe deri në nxjerrjen e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje që do të ketë nevojë për shpalosje në pasqyrat financiare.